

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5519
E premte, 6 korrik 2018
çmimi 0.40 €

Dënohen me 82 vjet burgim sulmuesit e Ziadin Selës

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

PROBLEME THEMELORE TË PUNIMEVE STUDIMORE (2)

F. 11

Hajdin ABAZI



LËVIZJA FOL LANSOI PORTALIN PËR PROKURIM TË HAPUR DHE TRANSPARENT

F. 6

GASHI E AHMETI FLASIN PËR SIGURINË NË KRYEQYTET, PRIORITET VENDOSJA E KAMERAVE

F. 6

EKONOMI

MINATORËT E 'TREPÇËS' PROTESTUAN PËR TË DREJTAT E TYRE

F. 8

EDHE 'INFRAKOS'-i KALON NË VALA

F. 9

KULTURË

RRËNOHET EDHE NJË NDËRTESE E TRASHËGIMISË NË PRIZREN

F. 13

SPORT

GASHI: PALESTRA NË SAMADREXHË PËRFUNDON KËTË VIT

F. 15



FLET PËR "EPOKËN E RE", REJHAN VUNIQI

FAQE 4-5

Nuk ka asnjë revokim të njohjeve

Zëvendësministrja e Punëve të Jashtme, Rejhan Vuniqi, në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ka mohuar se ka ndodhur ndonjë revokim i njohjeve për Kosovën. Ajo ka thënë se Serbia është duke bërë një fushatë të rreme lajmesh e mbështetur nga "Sputnik" dhe media të tjera. Sipas zëvendësministres Vuniqi, Serbia po abuzon me gjendjen ekonomike të disa vendeve duke përdorur diplomacinë e dollarit për të marrë nota verbale të falsifikuara. Ajo ka paralajmëruar njohje të reja për Kosovën, duke thënë se disa vende janë në proces të vendimit për njohjen e shtetit të Kosovës. Duke folur për liberalizimin e vizave, Vuniqi ka thënë se presin që Komisioni Evropian do ta rekomandojë dhënien e udhëtimit pa viza për qytetarët e Kosovës, ndërsa sa i përket anëtarësimit në Interpol, ajo ka bërë me dije se janë duke punuar që Kosova të bëhet anëtare e Interpolit.

POZITA DHE OPOZITA U "PËRPLASËN" NË KUVENDIN E
KOSOVËS PËR 53 MILIONËSHIN QË IU DHA KOMPANISË
"BECHTEL ENKA" PËR AUTOSTRADËN

FAQE 9

Haradinaj: Borxhin prej 53 milionë eurosh e krijoi Qeveria e udhëhequr nga Mustafa

Të enjten në Kuvendin e Kosovës kryeministri Ramush Haradinaj është "përplasur" me deputetët e opozitës për 53 milionë eurot që

iu dhanë kompanisë "Bechtel Enka" për autostradën Prishtinë - Hani i Elezit. Haradinaj ka akuzuar qeverinë paraprake, të

drejtuar nga ish-kryeministri Isa Mustafa, për borxhin e grumbulluar ndaj kompanisë "Bechtel Enka"



Pjesëtarë të komunitetit serb, të shtyrë nga presioni, po e braktisin FSK-në

FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel & Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Holanda mbështet hapjen e negociatave me Shqipërinë

Presidentja e Senatit holandez, Anki Brukers-Knol, gjatë takimit me kryeparlamentarin Gramoz Ruçi, ka thënë se gjatë këtij viti Shqipëria do t'i përmbushë të gjitha kushtet dhe ky vit do të jetë viti i "PO"-së për Shqipërinë

TIRANË, 5 KORRIK - Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Gramoz Ruçi, priti të enjten në një takim presidenten e Senatit të Holandës, Anki Brukers-Knol, dhe delegacionin që e shoqëronte, të cilët po zhvillojnë një vizitë zyrtare në Shqipëri. Ky ishte takimi i parë i kryetarit të Kuvendit pas vendimit të Këshillit Evropian, i cili iu përgjigj pozitivisht rekomandimit të Komisionit dhe përcaktoi rrugën drejt hapjes së negociatave të pranimit me Shqipërinë në qershor 2019.

Kryetari Ruçi i shprehu presidentes Anki Brukers-Knol mirënjohjen e Kuvendit të Shqipërisë si dhe të gjithë shqiptarëve, për mbështetjen e vazhdueshme dhe korrekte të Holandës për perspektivën evropiane të Shqipërisë. "Ne jemi të bindur se në qëndrimin e Holandës për çështjen e hapjes së negociatave me Shqipërinë nuk ka asnjë grimcë paragjykimi, por vetëm vëmendje e kujdes të natyrshëm", theksoi Ruçi. Ai tha se vërejtjet e Holandës po shqyrtohen me shumë seriozitet nga të gjitha institucionet shqiptare dhe lufta kundër korrupsionit, kriminalitetit dhe trafikëve po ashpërsohet e thellohet.

Njëkohësisht, Ruçi shprehu garancinë se përpjekjet e Kuvendit të Shqipërisë për thellimin dhe qëndrueshmërinë e arritjeve në pesë prioritetet kyçe të procesit të integritetit do të vazhdojnë të rriten dhe do të prodhojnë rezultate më të prekshme e më të larta.

Kuvendi i Shqipërisë ka përgatitur agjendën e vet për ta garantuar legjitimitetin demokratik dhe kontrollin ligjor e politik të procesit përgatitor për hapjen e negociatave.

Kuvendi po nxit qeverinë të punojë me Komisionin Evropian për procesin përgatitor, në mënyrë që qershorin e ardhshëm t'i kemi përmbushur të gjitha detyrimet. Deri në qershor 2019, vuri në dukje Ruçi, Shqipëria do t'i ketë bërë të gjitha detyrat e shtëpisë.

Kryetari i Kuvendit vlerësoi kontributin e Holandës për kryerjen e reformave, sidomos reformës në drejtësi, si një reformë unike në vendet kandidate dhe nënvizoi se suksesi i kësaj reforme buron edhe nga kontributi i institucioneve dhe gjyqtarëve holandezë në zbatimin e reformës dhe në strukturat e vetingut. "Testi deri në qershor 2019 që kemi përpara është një test si për shumicën qeverisëse, ashtu edhe për opozitën. Sepse është një sfidë për Shqipërinë", nënvizoi Ruçi.

Ndërkaq presidentja Anki Brukers-Knol theksoi se ka ardhur këtu me bindjen se Shqipëria do të bëhet një anëtare solide e Bashkimit Evropian. "Holanda është e bindur se Shqipëria është një vend evropian dhe me një të ardhme të qartë evropiane. Qëndrimi i Holandës për çështjen e hapjes së negociatave është një mundësi shumë e mirë për ta nxitur Shqipërinë të luftojë më ashpër kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.



Vetting-u është një rast unik dhe rezultatet që ju kemi arritur në këtë aspekt janë impresionuese. Jam e bindur se në qershor 2019 negociatat me Shqipërinë do të hapen. Gjatë këtij viti që kemi përpara Shqipëria do t'i përmbushë të gjitha kushtet. Ky vit do t'i bindë

të gjithë kritikët dhe në qershor 2019 askush nuk do të ketë pakënaqësi për rezultatet e Shqipërisë". "Ky vit, theksoi Brukers-Knol, është viti i 'PO'-së për Shqipërinë".

Bashkëbiseduesit evidentuan edhe zgjerimin e bashkëpunimit ekonomik midis Shqipërisë dhe

Holandës. Rritja e bashkëpunimit politik është pasuar edhe nga rritja e konsiderueshme e investimeve holandeze në Shqipëri. Në vitin 2017 Holanda u bë investitorja e dytë në Shqipëri, me 870 milionë euro, ose një rritje prej 30 % krahasuar me vitin e kaluar.

Lu: Kapni peshqit e mëdhenj!

TIRANË, 5 KORRIK - Ambasadori amerikan në Tiranë, Donald Lu, hodhi kritika të forta në drejtim të autoriteteve për mosarrestimin e Klement Balilit, duke theksuar se autoritetet nuk kanë pasur aftësinë ose vullnetin për ta arrestuar. Lu tha se kokat e krimit duhet të kenë frikë pasi drejtësia për ta po vjen.

"Shqipëria mbështeti arrestimin e Met Kananit në Turqi. Banda e tij u arrestua këtu në Shqipëri. Doganat shqiptare zbuluan 630 kg kokainë kolumbiane, që çoi në arrestimin e trafikantit të narkotikëve, Arbën Çekaj në Gjermani. Disa prej anëtarëve të bandës së tij janë arrestuar dhe



shpresojmë që ditët e ardhshme të arrestohen të tjerë. Së katërti, kryebashkiaku Fran Frrokaj dhe ish-kryebashkiaku Elvis Roshi, po ndiqen penalisht. Emiljano Shullazi dhe Lul Berisha po gjykohen në Gjykatë.

Hetimi penal kundër ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri dhe ish-kryeprokurorit të përgjithshëm

Adriatik Llalla vazhdon. Ka shumë aktivitete për një periudhë të shkurtër kohe, por duam të shohim rezultate konkrete. Duam që peshqit e mëdhenj të ndiqen penalisht, të dënohen dhe futen në burg. Ky do të ishte sukses", tha ambasadori Lu.



Dënohen me 82 vjet burgim sulmuesit e Ziadin Selës

SHKUP, 5 KORRIK - Gjykata Penale e Shkupit ka dënuar me gjithsejtë 82 vjet burgim shtatë të akuzuarit për tentim-vrasje të liderit të Aleancës për Shqiptarët, Ziadin Sela, më 27 prill të vitit 2017 në Kuvendin e Maqedonisë.

Nikolla Vojmovski është dënuar me 13 vjet e gjashtë muaj burgim, ndërsa me nga 13 vjet Kire Georgievski dhe Aleksandar

Janevski-Toshta.

Me nga 10 vjet burgim janë dënuar Andrej Micov, Nikollce Dimitrievski, Oliver Oshakovski dhe Kosta Dellov. Të akuzuarit ditën kritike, më 27 prill, pas ndërhyrjes së dhunshme në Kuvend, me paramendim kishin tentuar ta likuidojnë Ziadin Selën. Të gjithë të akuzuarit kishin role të veçanta... vepra është e rëndë edhe për faktin se

sulmi është bërë ndaj institucionit ligjvënës, përkatësisht Ziadin Selës, i cili, në momentin e sulmit, ishte në vendin e punës", ka deklaruar gjykatësja Sllavica Andreevska.

Prokurori i lëndës ka kërkuar që të gjithë të dënuarve t'u vazhdohet paraburgimi derisa vendimet të bëhen të plotfuqishme, pasi pala mbrojtëse ka të drejtën e ankesës në Gjykatën e Apelit.

Këshilli i Sigurisë i Kosovës ka mbajtur mbledhje të jashtëzakonshme rreth presionit të Beogradit ndaj pjesëtarëve të FSK-së nga radhët e komunitetit serb

Pjesëtarë të komunitetit serb, të shtyrë nga presioni, po e braktisin FSK-në

Pas presioneve të Beogradit, disa pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) të komunitetit serb kanë paraqitur kërkesë për t'u tërhequr nga kjo forcë. Kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë me dije se tashmë institucionet e Kosovës kanë ndërmarrë veprimet e nevojshme në lidhje me këto presione që po i detyrojnë pjesëtarët nga komuniteti serb ta braktisin FSK-në

kanë paraqitur kërkesat për t'u tërhequr nga kjo forcë. "Së fundmi ka rezultuar me kërkesën për lirim nga FSK-ja të një numri të pjesëtarëve serbë të Kosovës, nga një rajon i Kosovës që nuk është veriu në këtë rast. Shumica e tyre në deklarimet për lirim paraqesin presionin e ushtruar nga autoritetet e Beogradit zyrtar", është shprehur Haradinaj, duke thënë se presionet janë të natyrave të ndryshme qoftë gjatë udhëtimeve në Serbi, ndalimi dhe marrja në pyetje, kërçenimet për jetën dhe për familjet e tyre e deri tek instrumentet tjera që janë përdorur, përfshirë edhe mekanizmat e tjerë të institucioneve paralele që operojnë në Kosovë. "Raportohet edhe në media, për sulme me

armë dhe mjete shpërthyes që e rrezikojnë jetën e pjesëtarëve serbë të FSK-së. Këto në të kaluarën kanë ndodhur në veri, pastaj është raportuar edhe për kërçenime të tjera, por së fundi ka rezultuar me kërkesën për lirim të FSK-së nga një numër i pjesëtarëve serbë nga një rajon i Kosovës", ka theksuar Haradinaj. Megjithatë, sipas kryeministrit Haradinaj, kjo gjendje nuk mund të konsiderohet se ka prishur sigurinë kombëtare të Republikës së Kosovës. "Kjo situatë nuk ndikon në situatën e përgjithshme të sigurisë në Kosovë dhe se institucionet e sigurisë së Kosovës janë në nivel të përgjegjësive", ka thënë ai. I pyetur nga gazetarët nëse sulmet tek pjesëtarët e komunitetit

serb lidhen me paralajmërimin nga ana e serbëve që nuk pranojnë që në të ardhmen të jenë pjesë e FSK-së pas transformimit të saj në ushtri, kryeministri Haradinaj nuk e ka konfirmuar një gjë të tillë, mirëpo ka thënë se në vitet e mëhershme ka pasur një qasje nga Beogradi zyrtar që serbët e Kosovës nuk duhet të marrin fare pjesë në institucionet e Kosovës. "Sot serbët e Kosovës janë qytetarë të barabartë në Kosovë dhe marrin pjesë në jetën politike, institucionale, qeverisëse dhe shoqërore në vend. Ky presion i tillë është i pakuptimtë, të cilit i ka dalë koha, sepse këto metoda kanë ndodhur para 10 vjetësh dhe jemi të habitur nga kjo qasje e tillë, e padrejtë", ka deklaruar kryeministri Haradinaj.

**EPOKA
ERE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 5 KORRIK - Këshilli i Sigurisë i Kosovës të enjten ka mbajtur mbledhjen e jashtëzakonshme, në të cilën është diskutuar për presionet dhe shantazhet që është duke i bërë Beogradi ndaj pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës nga radhët e komunitetit serb si dhe për gjendjen e përgjithshme të sigurisë në vend. Me këtë rast, kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se presionet e Beogradit ndaj pjesëtarëve serbë të FSK-së janë krim ndaj qytetarëve të Kosovës. Ai ka bërë me dije se institucionet shtetërore tashmë i kanë ndërmarrë veprimet e nevojshme në lidhje me këto presione, që po i detyrojnë pjesëtarët nga komuniteti serb ta braktisin FSK-në. "Ky presion është i pakuptimtë, është i dalë koha sepse këto metoda kanë ndodhur para dhjetë vjetësh dhe jemi të habitur nga kjo qasje. Është shumë e padrejtë sepse dikush po ushtron krim ndaj këtyre qytetarëve të Kosovës, ndaj këtyre të rinjve dhe të rejave, si dhe ndaj familjeve të tyre. Ky presion është kundër konventave, është kundër të drejtave të njeriut, kundër sigurisë së këtyre

qytetarëve. Ne si Kosovë kemi vepruar me kohë, duke ndërmarrë veprime si në planin e jashtëm, po ashtu edhe në atë të brendshëm, që të sqarohet ky veprim i papranueshëm", ka deklaruar Haradinaj në një konferencë me gazetarë. Ai ka treguar se pas presioneve të Beogradit, disa pjesëtarë të FSK-së nga komuniteti serb



Gashi e Ahmeti flasin për sigurinë në kryeqytet, prioritet vendosja e kamerave

**EPOKA
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 5 KORRIK - Ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, ka vizituar të enjten Komunën e Prishtinës, ku është pritur nga kryetari Shpend Ahmeti. Gashi e Ahmeti kanë diskutuar për projekte të përbashkëta në mes të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Komunës së Prishtinës. Në këtë takim theks i veçantë iu kushtua bashkëpunimit të Policisë së Kosovës dhe Komunës së



Prishtinës sa i përket organizimit të trafikut gjatë sezonit të verës, ku ka më shumë ngarkesë të trafikut për shkak edhe të ar-

hjes së mërgimtarëve. Ministri Gashi me këtë rast ka shprehur gatishmërinë e plotë të Ministrisë së Punëve të

Brendshme për avancimin e sigurisë në bashkësi, sidomos vëzhgimet afër shkollave, me qëllim të parandalimit të shitjes dhe përdorimit të drogave. Ai ka thënë se janë shumë të rëndësishme edhe Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në raportimin e rasteve për sigurinë në komunitet. Ndërsa kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka theksuar se është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi me MPB-në, sidomos në fazën e

implementimit të Ligjit për Prishtinën, për formën e organizimit të policisë komunale dhe për këtë është shumë e rëndësishme që të rregullohet sipas formave që organizohen kryeqytetet e rajonit. Në këtë takim u bisedua edhe sa iu përket projekteve për ndërtimin e objektit për prodhim të dokumenteve, për ndërtimin e tri stacioneve policore dhe për përfshirjen e plotë të kamerave të Komunës së Prishtinës me Policinë e Kosovës, me qëllim rritjen e sigurisë në kryeqytet.

Flet për "Epokën e re", Rejhan Vuniqi

Nuk ka asnjë rev

- Serbia po e përdorë diplomacinë e dollarit për të marrë disa nota verbale të falsifikuara

Zëvendësministria e Punëve të Jashtme, Rejhan Vuniqi, në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ka mohuar se ka ndodhur ndonjë revokim i njohjeve për Kosovën. Ajo ka thënë se Serbia është duke bërë një fushatë të rreme lajmesh e mbështetur nga "Sputnik" dhe media të tjera. Sipas zëvendësministres Vuniqi, Serbia po abuzon me gjendjen ekonomike të disa vendeve duke përdorur diplomacinë e dollarit për të marrë nota verbale të falsifikuara. Ajo ka paralajmëruar njohje të reja për Kosovën, duke thënë se disa vende janë në proces të vendimit për njohjen e shtetit të Kosovës. Duke folur për liberalizimin e vizave, Vuniqi ka thënë se presin që Komisioni Evropian do ta rekomandojë dhënien e udhëtimit pa viza për qytetarët e Kosovës, ndërsa sa i përket anëtarësimit në Interpol, ajo ka bërë me dije se janë duke punuar që Kosova të bëhet anëtare e Interpolit

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Zëvendësministria e Punëve të Jashtme, Rejhan Vuniqi, ka bërë me dije se Kosova ka reaguar shpejt dhe me sukses ndaj përpjekjes së Serbisë për t'i revokuar njohjet e Kosovës. Ajo ka deklaruar se deri më tani nuk ka asnjë revokim të njohjeve për shtetin e Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Vuniqi ka treguar se me vendet që po i përmend Serbia, Kosova ka forcuar bashkëpunimin dypalësh. "Nuk ka revokim të njohjes. Të gjitha vendet që po i referoni e kanë njohur Kosovën. E keni parë me Liberi, Guinea-Bissau, Gambia, Gana etj. Efekti që Serbia krijon është e kundërta e asaj që homologët tanë në Beograd mendojnë. Ne vetëm po forcojmë marrëdhëniet me ato vende. Por, ne duhet të jemi të kujdesshëm se çfarë po bën Ministria e Jashtme e Serbisë. Ajo po bën fushatë të rreme lajmesh e mbështetur nga 'Sputnik' dhe media të tjera", ka thënë Vuniqi. Ajo ka deklaruar se edhe Serbia po abuzon me gjendjen ekonomike të disa vendeve duke përdorur diplomacinë e dollarit për të marrë disa nota verbale të falsifikuara. "Nuk

mund të shkoni në një vend tjetër dhe të thoni se nuk njihni një vend tjetër. Është krejtësisht jodiplomatik dhe Serbia po abuzon me gjendjen ekonomike të disa vendeve duke ofruar ndihmë ushtarake, stimulime financiare, heqjen e vizave etj. Ne kemi shprehur shqetësimin tonë se Serbia si një vend kandidat i BE-së po e përdorë diplomacinë e dollarit për të marrë disa nota verbale të rreme/falsifikuara. Në një formulim tjetër kjo është korrupsioni. Në të njëjtën kohë po shkelet rregulli i Shengenit me të cilin Serbia është e detyruar të mbetet e angazhuar në listën e bardhë të Shengenit", është shprehur Vuniqi.

Më tej, ajo ka vlerësuar se është duke u punuar për sjelljen e njohjeve të reja. Sipas saj, disa vende janë në proces të vendimit për njohjen e shtetit të Kosovës. "Procesi i njohjes po shkon më tej dhe ne jemi duke punuar me disa vende që janë në proces për të marrë një vendim. Unë nuk do t'i përmend vendet dhe rajonet, por përpjekjet tona janë globale. Ne do të shohim rezultate konkrete dhe kur qeveritë janë gati ta shpallin njohjen, ne do ta bëjmë këtë. Në të njëjtën kohë po forcojmë pozitën e Kosovës në organizatat ndërkombëtare", ka deklaruar Vuniqi.



"Epoka e re": Znj. Vuniqi, së fundi Serbia ka shtuar përpjekjet për ta penguar konsolidimin e sovranitetit të shtetit të Kosovës duke penguar edhe njohjet e reja. Çfarë ka ndërmarrë Ministria e Punëve të Jashtme për t'iu përgjigjur kësaj përpjekje të Serbisë?

Vuniqi: Procesi i njohjes së Kosovës është projekti më i

suksesshëm i politikës së jashtme të Kosovës. Kjo nuk është diçka e mirëpritur nga Serbia dhe duke sulmuar këtë proces, Serbia përpiket ta vazhdojë politikën e vjetër të njohur për ta kundërshtuar pavarësinë e Kosovës. Kosova është e pavarur dhe e njohur nga 116 vende dhe, si e tillë, do të vazhdojë ta rrisë angazhimin

dypalësh me të gjithë anëtarët e bashkësisë ndërkombëtare. Ministria e Punëve të Jashtme ka reaguar shpejt dhe me sukses në përpjekjet e Serbisë për ta revokuar njohjen e Kosovës. Ne po komunikojmë me të gjitha vendet që e kanë njohur Kosovën duke forcuar bashkëpunimin tonë dypalësh, duke emëruar ambasadorët

okim të njohjeve



jodiplomatike. Serbia po abuzon me gjendjen ekonomike të disa vendeve duke ofruar ndihmë ushtarake, stimulime financiare, heqjen e vizave etj.

Ne kemi shprehur shqetësimin tonë se Serbia si një vend kandidat i BE-së po e përdorë diplomacinë e dollarit për të marrë disa nota verbale të rreme/falsifikuara. Në një formulim tjetër, ky është korrupsion. Në të njëjtën kohë po shkelet rregulli i Shengenit me të cilin Serbia është e detyruar të mbetet e angazhuar në listën e bardhë të Shengenit. Ajo po heq regjimin e vizave për vendet që potencialisht në një kohë krize migrimi në Evropë mund të kontribuojnë në përdorimin e Ballkanit si një zonë transiti. Ky është një shqetësim për Kosovën dhe Bashkimi Evropian duhet të jetë i shqetësuar se kriteret e tij bazë nuk respektohen nga vendet e tjera të rajonit. Dhe, ne i kemi ngritur këto shqetësime në Bruksel.

"Epoka e re": Ka pasur raste konkrete që Serbia ka pretenduar që ka arritur të nxisë shtete të caktuara për ta tërhequr njohjen për shtetin e Kosovës. Pse mendoni se po ndodh kjo?

Vuniqi: Nuk ka revokim të njohjes. Të gjitha vendet që po u referoheni e kanë njohur Kosovën. Pra, Liberia, Guinea-Bissau, Gambia, Gana etj. Efekti që Serbia krijon është e kundërta e asaj që homologët tanë në Beograd mendojnë. Ne vetëm po forcojmë marrëdhëniet me ato vende. Por, ne duhet të jemi të kujdesshëm se çfarë po bën Ministria e Jashtme e Serbisë. Ajo po bën një fushatë të rreme lajmesh e mbështetur nga 'Sputnik' dhe media të tjera. Ata nuk kujdesen nëse luajnë me imazhin e një vendi tjetër. Ata duan të krijojnë një tregim të rremë që pavarësia e Kosovës është një punë e papërfunduar. Por, nuk është kështu dhe ne do të vazhdojmë ta bëjmë punën tonë për t'i mbrojtur interesat e Kosovës jashtë vendit dhe do të kundërshtojmë Serbinë më tej.

"Epoka e re": Prej objektivave më të rëndësishme të politikës së jashtme është shtimi i njohjeve të reja dhe anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare. Gjatë kësaj vere mund të presim ndonjë njohje të re?

Vuniqi: Proces i njohjes po shkon më tej dhe ne jemi duke

punuar me disa vende që janë në proces për të marrë një vendim. Unë nuk do t'i përmend vendet dhe rajonet, por përpjekjet tona janë globale. Ne do të shohim rezultate konkrete dhe kur qeveritë janë gati ta shpallin njohjen, ne do ta bëjmë këtë. Në të njëjtën kohë po forcojmë pozitën e Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Kohët e fundit kemi pasur Organizatën Botërore të Doganave, e cila është një element tjetër i keqpërdorur nga Serbia. Qeveria serbe dhe mediet raportuan se Kosova është pezulluar, por fakti është se Kosova ishte ulur si një anëtare e barabartë dhe e plotë. Po punojmë edhe për disa organizata dhe konventa të tjera. Në javët dhe muajt e ardhshëm do të shohim rezultate konkrete.

"Epoka e re": Synimet janë që së shpejti Kosova të bëhet anëtare e UNESCO-s dhe Interpol-it. Sa po përgatitet Kosova për këto procese dhe cilat janë gjasat për t'u bërë anëtare e këtyre organizatave?

Vuniqi: Këtë vit jemi në agjendën e Interpol-it dhe në Dubai në nëntor do të zhvillohet votimi. Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Brendshme, Policia e Kosovës dhe institucionet e tjera po punojnë përmes një grupi pune të krijuar posaçërisht që lobon dhe punon me vendet për ta fituar mbështetjen e nevojshme. Ishte një betejë e ashpër për të hyrë në agjendë, por qasja dhe puna e drejtë ka përfunduar me sukses. Tani jemi duke punuar drejtpërsëdrejti me vendet për ta arritur rezultatin e synuar për t'u bërë anëtar i Interpolit. Edhe partnerët e Kosovës po mbështesin jashtëzakonisht këtë proces. Në lidhje me UNESCO-n, ky është një projekt që do të fokusohemi vitin e ardhshëm kur Asambleja e Përgjithshme të mblidhet në nëntor 2019. Deri në fund të vitit do të merret një vendim për qasjen që Kosova do ta ndjekë, por Ministria e Punëve të Jashtme është e gatshme për ta filluar punën. Kosova duhet të bëjë disa detyra para se të aplikojmë për UNESCO, duke miratuar Ligjin për liritë fetare, Ligjin mbi trashëgiminë kulturore dhe për marrjen e masave për t'i rreguar botës që trashëgimia fetare dhe kulturore në Kosovë është e garantuar sipas standardeve më të larta

ndërkombëtare. Sapo t'i bëjmë detyrat e shtëpisë në Parlament, aq më mirë dhe më e fortë do të jetë aplikimi i Kosovës në UNESCO dhe Serbia nuk do të jetë në gjendje të abuzojë me të.

"Epoka e re": Kosova është në pritje të rekomandimit të Komisionit Evropian për liberalizimin e vizave. Sa është lobuar tek vendet anëtare të BE-së që, pas rekomandimit të KE-së, këto vende ta përkrahin liberalizimin e vizave për Kosovën?

Vuniqi: Presim që Komisioni Evropian do ta rekomandojë dhënien e udhëtimit pa viza për qytetarët e Kosovës në Zonën Shengen. Ne jemi të bindur se ky është një proces i pandalshëm. Kosova ka bërë punën e

saj, ka qenë gjithmonë argumenti i BE-së se ky është një proces teknik dhe jo politik dhe ne presim të njëjtën gjë që ky do të jetë një proces thjesht teknik. Natyrisht, Evropa po kalon sfida të vështira për shkak të debateve të migracionit midis vendeve kryesore të BE-së, zgjedhjeve të ardhshme për Parlamentin Evropian, rritjes së ekstremit të krahut të djathtë etj. Por, jemi optimistë se kjo nuk do të ketë ndikim në proces. Unë kam qenë me ministrin Pacolli në disa kryeqytete evropiane në javët e fundit dhe reagimet që marrim janë pozitive, por puna duhet të vazhdojë me të gjitha vendet dhe kemi një qasje të qartë ndaj institucioneve të BE-së dhe shteteve anëtare si të llojshmë.



AKR-ja është duke bërë punë të madhe në Qeveri

"Epoka e re": AKR-ja është pjesë e kësaj Qeverie. Sa jeni e kënaqur me performancën e Qeverisë, dhe a po keni hapësirë si parti për të vepruar në kuadër të koalicionit?

Vuniqi: AKR-ja ka marrë përgjegjësitë dhe obligimet e veta në raport me Qeverinë dhe qeverisjen. Në kuadër të Qeverisë së Kosovës, AKR-ja ka hapësirën e mjaftueshme për ta implementuar programin dhe vizionin politik që përfaqëson. Në këtë kontekst, personalisht mendoj se është duke u bërë punë e madhe në përgjithësi në Qeverinë Haradinaj, veçanërisht nga dikasteret që udhëhiqen nga AKR-ja.

jorezidentë dhe hapjen e misioneve të reja diplomatike për ta forcuar praninë e Kosovës në të gjitha anët e botës etj. Duhet të jetë e qartë se nuk ka revokim e njohjes në të drejtën ndërkombëtare dhe praktikën diplomatike. Nuk mund të shkoni në një vend tjetër dhe të thoni se nuk njihni një vend tjetër. Është krejtësisht

Lëvizja FOL lansoi portalin për prokurim të hapur dhe transparent

EPOKA E RE **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 5 KORRIK - Lëvizja FOL, me mbështetjen e USAID-it Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënese, ka bërë të enjten lansimin e "Portalit të prokurimit të hapur dhe transparent".

Drejtoresha ekzekutive e Lëvizjes FOL, Mexhide Demolli-Nimani, ka thënë se ky portal është një ndër aktivitetet më të rëndësishme që FOL ka bërë gjatë punës disavjeçare në monitorimin e prokurimit publik. "Është kënaqësi për ne si FOL, që sot të prezantojmë këtë portal i cili objektiv kryesor ka ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies sa i përket shpenzimit të parasë publike nga institucionet e Kosovës. Ky portal nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen e USAID-it përmes Aktivitetit Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënese (USAID

TEAM)", ka thënë Demolli-Nimani, duke falënderuar edhe Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) për bashkëpunimin, pa të cilin ky portal nuk do të ishte i plotë.

Zëvendësambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Coline Hyland, ka thënë se ky portal mundëson krijimin e një ambienti për bizneset dhe reduktimi i rreziqut nga korrupsioni në sferën publike nuk është një punë e lehtë. "Për ta reduktuar korrupsionin në sferën publike është i nevojshëm dhe esencial një bashkëpunim i vazhdueshëm në mes të institucioneve qeveritare dhe shoqërisë civile. Për këtë dua ta falënderoj z. Safet Hoxha dhe KRPP-në që shërben si një shembull i mirë se si duket ky bashkëpunim. Kjo vlen edhe për partnerët e tjerë siç është Lëvizja FOL, që ka mbledhur të dhëna të marra nga KRPP që t'i kalkulojë në të mirë të transparencës", ka deklaruar Hyland.

Ndërsa kryetari i Bordit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, Safet Hoxha, ka thënë se mediet dhe shoqëria civile janë partnerët strategjikë që mund ta adresojnë luftën kundër korrupsionit në prokurimin publik në Kosovë. "Së bashku jemi duke arritur në mënyrë dinamike ta luftojmë korrupsionin. Në këtë betejë tonën gjithsesi është cruciale asistenca e donatorëve, të cilët sot po e ndajnë me ne punën dhe rezultatin e angazhimit dhe të investimit të tyre", ka thënë ai, duke shtuar se bizneset duhet të trajtohen si partnerë të shtetit të Kosovës.

Ndërkaq Jeton Zulfaj, menaxher i programeve në Lëvizjen FOL, i cili ka prezantuar portalin, ka theksuar se të dhënat në këtë portal grumbullohen në mënyrë automatike nga platforma elektronike e prokurimit dhe paraqiten në një mënyrë miqësore për përdoruesin, duke u mundësuar hulumtuesve, biz-



neseve dhe hetuesve t'i eksplorojnë lidhjet interaktive midis rrjedhjes së parasë, aktorëve publikë dhe atyre privatë. "Portali i transparencës në prokurim publik në Kosovë ka potencial transformues në promovim të llogaridhënies dhe luftimit të korrupsionit. Portali lehtëson aktivitetet monitoruese nga organizatat e shoqërisë civile (OSHC), gazetarët hulumtues, sektori privat

dhe publiku i gjerë", ka thënë ai, duke shtuar se qasja në informacion i ndihmon publikut ta përcjellë se ku shpenzohen paratë, duke i bërë institucionet publike të Kosovës më transparente dhe llogaridhënese. Gjithashtu, në mesin e komunitetit të biznesit, portali i transparencës do ta mënjanë asimetritë në informim dhe kështu do ta rrisë konkurrencën e shëndetshme.

Prezantohet raporti fillestar i studimit të fizibilitetit në shëndetësi

PRISHTINË, 5 KORRIK (ER) - Në prani të ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, përfaqësuesve të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Integritimit Evropian dhe përfaqësuesve të ShSKUK-së, të enjten në Ministrinë e Shëndetësisë, nga ekipi i ekspertëve që kanë ardhur nga Evropa në Kosovë, është prezantuar raporti fillestar i projektit të studimit të fizibilitetit të pajisjeve për Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës.

Ministri Ismaili ka thënë se ky projekt ka rëndësi shumë të madhe për përmirësimin e gjendjes në sistemin shëndetësor, me theks të veçantë na



tregon për nevojat që ka ShSKUK-ja. "Me sigurimin e këtyre pajisjeve mjekëve tanë do t'u krijojmë kushte më të

mira për punë, ndërsa qytetarëve tanë shërbime shëndetësore më cilësore", ka thënë Ismaili.

Projekti ka për qëllim ta vlerësojë gjendjen ekzistuese të infrastrukturës së pajisjeve mjekësore në Kujdesin Dytësor

dhe Tretësor shëndetësor në Kosovë dhe nevojat për: pajisje të reja, staf shtesë profesional, trajnime specifike të stafit për përdorimin e pajisjeve, mbështetje teknike dhe material shpenzues për pajisjet. Studimi do t'i hapë rrugë projektit prej dhjetëra milionë eurosh për blerjen e pajisjeve mjekësore. Ndërsa në gjysmën e vitit 2019 Ministria e Shëndetësisë do ta ketë gati marrëveshjen për financim, ku do të investohet në spitalet e vendit.

Synimi i këtij projekti është që në një periudhë afatmesme të adresohet problemi me pajisje mjekësore në institucionet shëndetësore.

Komandanti i FSK-së qëndroi për vizitë zyrtare në Turqi

PRISHTINË, 5 KORRIK (ER) - Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), gjeneraljetënant Rrahman Rama, me ftesë të komandantit të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, gjeneralit Hulusi Akar, nga data 1 deri më 5 korrik ka qëndruar për vizitë zyrtare në Turqi.

Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, është prituri nga komandanti i Forcave të Armatosura të


Turqisë, gjenerali Hulusi Akar, ku të dy gjeneralët gjatë takimit kanë biseduar për bashkëpunimin e deritashëm si dhe për mundësinë e rritjes së këtij bashkëpunimi në të ardhmen edhe në fusha të tjera, si: shkollim, edukim dhe stërvitje, e që janë me interes të përbashkët. Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, pasi e ka falënderuar komandantin e Forcave të Armatosura të

Turqisë, gjeneralin Akar, për mbështetjen e vazhdueshme të Ushtrisë së Turqisë në trajnimin dhe avancimin e FSK-së, si një forcë kredibile, gjithëpërfshirëse dhe të gatshme, si dhe për shkollimin e kadetëve në akademitë dhe shkollat ushtarake të Turqisë, e ka njoftuar edhe me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, si: shkollimet, trajnimet dhe bashkëpunimi rajonal dhe atë ndërkombëtar.



Ministrja Hoxha kërkon mbështetjen e Gjermanisë për liberalizimin e vizave??

Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, po qëndron për vizitë zyrtare në Gjermani. Ajo të enjten është takuar me homologun Michael Roth, prej të cilit ka kërkuar mbështetjen e Gjermanisë për liberalizimin e vizave



proces reformat janë kyçe. Ministri gjerman e ka siguruar ministrin Hoxha se Gjermania

do ta mbështesë Kosovën në procesin integruar dhe ka vlerësuar lart reformat e ndërmarra,

duke porositur të vazhdohet dialogu me Serbinë dhe reformat në sektorët kryesorë.

EPOKA
ERE

Arbisa SHEFKIU

BERLIN, 5 KORRIK - Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, në kuadër të vizitës zyrtare në Republikën Federale të Gjermanisë, ka zhvilluar takim me ministrin e Shtetit për Çështje Evropiane, Michael Roth. Gjatë këtij takimi, ministrja Hoxha e ka njoftuar homologun gjerman për zhvillimet e fundit në vend, reformat e ndërmarra si dhe përkushtimin e institucioneve të vendit për ta avancuar agjendën integruar. Me këtë rast, ministrja Hoxha ka kërkuar mbështetjen e Gjermanisë për procesin e liberalizimit të vizave duke potencuar se Kosova ka plotësuar kushtet e udhërrëfyesit për viza, gjithsej 95. Ajo ka njoftuar ministrin gjerman për përpjekjet e bëra në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe ka theksuar se ky angazhim do të vazhdojë edhe

pas liberalizimit të vizave.

Ministrja Hoxha ka thënë se qytetarët e Kosovës tashmë një kohë të gjatë presin liberalizimin e vizave dhe qytetarët tanë meritojnë lëvizjen e lirë. Po ashtu, ajo ka njoftuar ministrin Roth se Kosova ka ndërmarrë reformat e nevojshme për kontrollin e kufijve dhe ligjeve për të huajt, andaj liberalizimi i vizave nuk do të keqpërdoret nga qytetarët e Kosovës, duke theksuar se duhet dhënë mundësinë të rinjve tanë që të udhëtojnë lirshëm në vendet e BE-së, sepse Kosova beson fuqishëm në vlerat evropiane dhe kjo është rruga që kemi nisur, bashkimi me vlerat evropiane.

Ndërkaq ministri Roth ka falënderuar ministrin Hoxha për angazhimin dhe ka ofruar mbështetjen e Gjermanisë në rrugën integruar të Kosovës, duke vënë në dukje se mbetet shumë punë për t'u bërë drejt integritimit evropian dhe në këtë

Kërkohet zbatimi i strategjisë kundër terrorizmit



PRISHTINË, 5 KORRIK (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme (MPB), Bejtush Gashi, ka kërkuar të enjten mbështetje nga të gjitha autoritetet kompetente për zbatimin e

Strategjisë kundër terrorizmit. Ai gjatë takimit të grupit për mbështetje strategjike kundër terrorizmit dhe parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm, ka

kërkuar thellimin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional, në mënyrë që të reagojë me kohë përballë sfidave që mund të paraqiten. Gjithashtu, në këtë

takim është diskutuar për zhvillimet e tjera aktuale, përfshirë këtu trendin e kthimit të qytetarëve nga zonat e konfliktit si dhe për procesin e themelimit të Divizionit për

parandalim dhe riintegrim të personave të radikalizuar, si divizion i ri në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me qëllim të zbatimit më efikas të kësaj strategjie.

Policia e Kosovës arreston tre persona për trafikim të qenieve njerëzore

PRISHTINË, 5 KORRIK - Policia e Kosovës (PK) ka njoftuar se gjatë një kontrolli në një lokal në Prishtinë ka arrestuar tre persona të dyshuar për trafikim të qenieve njerëzore

dhe ka identifikuar një viktimë të trafikimit. Policia e ka cilësuar lokalin si "sallon masazhi". Në komunikatën e policisë është thënë se dyshohet që personat e

arrestuar kanë kryer veprën penale 'trafikim i njerëzve'. Përveç të tjerash, në komunikatë është thënë se me vendim të prokurorit, të dyshuarit janë dërguar në

mbajtje për 48 orë, viktimat është trajtuar në bazë të procedurave standarde për viktimat e trafikimit, ndërkaq lokali është mbyllur nga inspektorët përkatës.





Minatorët e 'Trepçës' protestuan për të drejtat e tyre

PRISHTINË, 5 KORRIK (ER) - Qindra punëtorë të "Trepçës" janë mbledhur të enjten para ndërtesës së Kuvendit të Kosovës dhe kanë protestuar për t'iu njohur të drejtat e tyre. Me thirrjet

"Trepça është e jona", "Jetën e japim, Trepçën se japim", ata kanë kërkuar të takohen me kryeministrin Ramush Haradinaj dhe kryeparlamentarin Kadri Veseli. Kërkesat e tyre janë njohja e

pensionit 70 për qind e pagës, mosha 50-55 vjet, Ligji për invalidët e punës, stazhi i përfutur, sigurimi shëndetësor në punë, njohja e stazhit 89-99 si dhe pensioni familjar.

Kryetari i Sindikatës së Minatorëve të "Trepçës", Shyqyri Sadiku, ka thënë se kjo protestë njëorëshe është paralajmëruese për institucionet e vendit që t'i plotësojnë të drejtat e punëtorëve.

Ai ka thënë se në rast se institucionet nuk marrin parasysh kërkesat e tyre atëherë do të hyjnë në greve dhe në protesta të cilat nuk do të ndalen deri në realizimin e kërkesave të tyre.



Edhe 'Infrakos'-i kalon në VALA

PRISHTINË, 5 KORRIK (ER) - I tërë personeli i Ndërmarrjes Publike "Infrakos" që nga fillimi i këtij muaji do të kenë numra të VALA-s sikurse pjesa më e madhe e institucioneve publike e shtetërore dhe kompanive të shumta private. Kjo u mundësua pas nënshkrimit të marrëveshjes nga ana e kryeshefit ekzekutiv të Telekomit të Kosovës, Gent Begolli dhe kryeshefit ekzekutiv të Ndërmarrjes Publike "Infrakos",

Agron Thaçi, marrëveshje kjo e cila automatikisht të gjithë stafin e kësaj ndërmarrje e kalon në operatorin publik VALA. "Me këtë marrëveshje të lidhur sot dhe ato që kemi lidhur deri më tani janë një tregues sinjektiv se gjithnjë e më tepër është duke u rikthyer besimi në shërbimet dhe produktet që ofron VALA, ndërkaq me përforsimet e bëra në rrjet si dhe me ofertat e reja që do t'i promovojmë në javët në vazhdim,

synojmë të kthejmë tek ne edhe shumë institucione të tjera", ka thënë kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Gent Begolli. Ndërsa kryeshefi ekzekutiv i "Infrakos"-it, Agron Thaçi, ka bërë me dije se tash e tutje personeli që ai udhëheq do të ketë lehtësime dhe përparësi të tjera të komunikimit që është një ndihmesë e madhe teknike për mbarëvajtjen e punëve operative.

ATK-ja, aktivitete shtesë gjatë sezonit të verës

Prishtinë, 5 korrik (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) në sezonin e verës ka një plan të veçantë të aktiviteteve i cili zhvillohet brenda dhe jashtë orarit të punës, me qëllim të monitorimit sa më të mirë të veprimtarive rekreative, argëtuese, përfshirë organizimet nëpër hotele dhe restorantet, koncertet, dasmat si dhe veprimtari të ngjashme, të cilat në këtë sezon janë më të theksuara. Sipas ATK-së, këto aktivitete ndërmerren në mënyrë që të sigurohen dëshmi të ndryshme në lidhje me të hyrat që realizohen nga ky sektor.

Bazuar në dëshmitë që krijohen gjatë këtyre aktiviteteve, si dhe bazuar në faktet e tjera që gjenden në mënyra të ndryshme, ATK-ja bën vlerësimin e obligimeve të këtij sektori. "Gjatë periudhës janar - qershor 2018 tek sektori i lartcekur janë realizuar 1 901 vizita, ku nga konstatimet e bëra janë lëshuar gjoba në vlerë 111 325 euro. Menaxhmenti i ATK-së me përkushtim do të vazhdojë t'i zbatojë të gjitha dispozitat ligjore në mënyrë që secili tatimpagues të deklarojë drejt pjesën që i takon me ligj!", ka njoftuar ATK-ja.



Pozita dhe opozita u "përplasën" në Kuvendin e Kosovës për 53 milionëshin që iu dha kompanisë "Bechtel Enka" për autostradën

Haradinaj: Borxhin prej 53 milionë eurosh e krijoi Qeveria e udhëhequr nga Mustafa



Të enjten në Kuvendin e Kosovës kryeministri Ramush Haradinaj është "përplasur" me deputetët e opozitës për 53 milionë eurot që iu dhanë kompanisë "Bechtel Enka" për autostradën Prishtinë - Hani i Elezit. Haradinaj ka akuzuar qeverinë paraprake, të drejtuar nga ish-kryeministri Isa Mustafa, për borxhin e grumbulluar ndaj kompanisë "Bechtel Enka". "Këtë 'minë' të pashpërthyer në tavolinën e Qeverisë Haradinaj e ka krijuar Qeveria e LDK-së, ish-kryeministri Mustafa, ish-ministri Lutfi Zharku dhe Avdullah Hoti", ka deklaruar Haradinaj

paninë ndërtuese ka qenë në pushtet, ka kritikuar Qeverinë Haradinaj për ndarjen e 53 milionë eurove pasi, sipas saj, vendimi ishte i padrejtë dhe joligjor. Ish-ministri i Infrastrukturës, Lutfi Zharku, tani deputet nga radhët e LDK-së, ka thënë se borxhi ndaj këtij konsorciumi, sipas vlerësimeve zyrtare, ka qenë mbi 14 milionë euro. Sipas tij, ndarja e mjeteve shtesë në bazë të kontratës mes kompanisë dhe Qeverisë është dashur të bëhet paraprakisht pas vlerësimeve nga kompania konsulente "Hill International", e cila i mbikëqyrë punimet në autostradë. "Kërkesa e 'Bechtel Enka'-s për koston shtesë prej 53.1 milionësh konsiderohet e pabazë. Natyrisht, ata e dinë se përmes keqpërdorimit të së drejtës nuk do të mund të fitonin në asnjë arbitrazh, prandaj kanë bërë marrëveshje me Qeverinë dhe ministrin Pal Lekaj, duke anashkaluar menaxherin e kontratës 'Hill International'. Prandaj, e vetmja zgjidhje ju mbetet ta shkarkoni ministrin Lekaj dhe gjithë kabinetin e tij për shkelje të ligjit, ta anuloni vendimin e Qeverisë për miratimin e koston shtesë prej 53.1 milionë

eurosh dhe zbatoni anekskontratën tanimë të rekomanduar nga menaxheri i kontratës 'Hill International' në shumën prej 14.78 milionë eurosh", ka thënë Zharku. Edhe për Lëvizjen Vetëvendosje 53 milionët eurot janë ndarë në mënyrë të parregullt. Deputeti nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Liburn Aliu, ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës ta bëjë publike marrëveshjen për këtë çështje. "Ky 53 milionësh (euro) që përmendet në raporte kudo, quhet si penalizimi i Qeverisë së Kosovës. Urdhëroni na i sillni dokumentet ku e si u penalizua. Për mua ky nuk është penalizim. Nuk është penalizimi i Republikës së Kosovës për punën në pagesë, por konkretisht është dhënë në mënyrë të parregullt ky 53 milionë eurosh", ka thënë Aliu. Ndërkaq kryeministri Ramush Haradinaj u është kundërpërgjigjur kritikave dhe akuzave të opozitës. Ai e ka akuzuar qeverinë paraprake, të drejtuar nga ish-kryeministri Isa Mustafa, për borxhin e grumbulluar ndaj kompanisë "Bechtel Enka". Haradinaj ka thënë se në bazë të kontratës, në rast të vonesave të pagesave

të faturave, thuhet se Qeveria duhet paguajë gjobë deri në 40 mijë euro për një ditë. Kryeministri ka arsyetuar pagesën e kërkuar nga operatori ekonomik, për të mos u përballur me procese gjyqësore. "Të gjitha të dhënat që u folën nga ish-ministri Zharku janë manipulime. Nëse ka një njeri në këtë Kosovë që e ka shkaktuar këtë borxh, është ministri i Infrastrukturës (Lutfi Zharku), nuk ka mundur ndryshe të burojë borxhi. Pse LDK-ja nuk e ka përmbyllur atë borxh?! Pse nuk e ka dhënë një nënshkrim dhe ta paguajë atë borxh prej 14.7 milionë eurosh?! Këtë borxh Kosovës, këtë 'minë' të pashpërthyer në tavolinën e Qeverisë Haradinaj, e ka krijuar Qeveria e LDK-së, ish-kryeministri Mustafa, ish-ministri Lutfi Zharku dhe Avdullah Hoti", ka deklaruar Haradinaj. Autostrada Prishtinë - Hani i Elezit, që lidh Kosovën me Maqedoninë, e cila kap shumën rreth 600 milionë euro, ka filluar në korrik të vitit 2014 dhe thuhet se do të jetë e gatshme për qarkullim në fund të vitit 2018. Mirëpo, kontrata në mes të kompanisë ndërtuese dhe Qeverisë asnjëherë nuk është bërë publike për opinionin.

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 5 KORRIK - Kuvendi i Kosovës ka mbajtur të enjten seancën e radhës në të cilën fokusi më i madh ka qenë për interpelancën e thirrur nga partitë opozitare, Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për pagesën e 53 milionë eurove shtesë për kompaninë "Bechtel Enka" rreth kontratës për ndërtimin e Autostradës R6, "Arbën Xhaferi" Prishtinë - Hani i Elezit. Kryeministri Ramush Haradinaj është përballur me kritika nga opozita në lidhje me vendimin e Qeverisë për

pagesën e 53 milionë eurove shtesë për kompaninë "Bechtel Enka". Deputetët e opozitës këtë vendim e kanë cilësuar joligjor. Kryeministri Haradinaj i ka hedhur poshtë kritikën e opozitës, duke arsyetuar dhe cilësuar si të domosdoshëm vendimin e Qeverisë për ndarjen e mjeteve shtesë për punimet në autostradë. Konsorciumi turko-amerikan "Bechtel Enka" kishte kërkuar mjete shtesë për shkak të dështimit të, siç është potencuar, Qeverisë së kaluar që t'i paguajë me rregull faturat. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e cila në kohën e nënshkrimit të kontratës me kom-

Rrënohet edhe një ndërtesë e trashëgimisë në Prizren

PRIZREN, 5 KORRIK (ER) - Ndërtesa që i takonte fillimit të shekullit XX, e ndërtuar me teknikë tradicionale të ndërtimit në rrugën "Adem Jashari" (nr. i ngastrës 804-0) në Prizren, është rrënuar në tërësi. Kjo ndërtesë është rrënuar me leje të Komunës së Prizrenit, gjegjësisht Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor (DUPH), edhe pse për rastin në fjalë Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë (QRTK) në Prizren, si institucion kompetent i trashëgimisë, nuk ka dhënë pëlqim për një veprim të tillë. "EC Ma Ndryshe" përmes një reagimi për medie vendimin e

Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor (DUPH) për rrënimin e ndërtesës në fjalë e konsideron si vendim jo të drejtë dhe kontradiktor. "EC Ma Ndryshe" vazhdimisht ka shprehur shqetësimin për shkatërrimin e vlerave të trashëgimisë kulturore në Prizren dhe kërkon nga Komuna e Prizrenit, gjegjësisht DUPH, të mos marrë hapa të ngutshëm të dhënies së lejes së rrënimin të ndërtesave të trashëgimisë, sepse humbja e vlerave të trashëgimisë është një proces i pakthyeshëm", është thënë në reagimin e "EC Ma Ndryshe".



Mungesë e transparencës në hartimin dhe zbatimin e politikave sociale në Prizren

PRIZREN, 5 KORRIK (ER) - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) në një konferencë për media të enjten ka publikuar analizën hulumtuese "Politikat sociale në nivel lokal" ku përfshihen komuna e Prizrenit, e Rahovecit dhe e Dragashit.

Hulumtimi nxjerrë në pah ngecjen në hartimin e planeve vjetore si dhe mirëmbajtjen e shërbimeve sociale dhe familjare në këto komuna. Fokusi i analizës është përqendruar në politikat e komunave për ndarjen e subvencioneve dhe programet e banimit social.

Naim Cahani nga KDI-ja në konferencë ka theksuar se, pavarësisht prej obligimeve ligjore të komunave për hartimin e planeve vjetore për mirëmbajtjen e shërbimeve sociale dhe familjare, asnjë nga komunat që përfshihen në kuadër të këtij hulumtimi nuk kanë dokumente të tilla.

Një gjë e tillë ka thënë se ka reflektuar në mungesë të transparencës dhe llogaridhënies së



komunave për përfshirjen e qytetarëve për hartimin dhe zbatimin e politikave sociale.

Tutje, ai ka potencuar mungesën e respektimit të procedurave dhe mungesën e

kritereve të qarta për dhënien e subvencioneve në nivel lokal. Kurse Elmedina Dorambari nga

KDI ka folur për politikat e financimit të Organizatave të Shoqërisë Civile që ofrojnë shërbime të caktuara sociale. "Gjatë hulumtimit është vërejtur mungesë kriteresh dhe uniformiteti, duke mos specifikuar në detaje se cilat nga kriteret duhet të përmbushen me qëllim të qasjes në subvencione nga ana e Organizatave të Shoqërisë Civile. Mungesa e politikave të brendshme mund të reflektojë në mungesë të transparencës dhe përjashtimin e shumë organizatave që ofrojnë shërbime sociale në territorin e komunave përkatëse", ka thënë Dorambari.

Sipas KDI-së, ky hulumtim e nxjerrë Komunën e Prizrenit si komunë të vetme e cila, në kuadër të politikave sociale, ka investuar në financimin e programeve të veçanta të banimit. Por Komuna e Prizrenit duhet të krijojë një mekanizëm shumëpalësh për monitorimin e zbatimit të kontratave me përfituesit aktualë.

Mbi 5 milionë euro dëme në Rahovec të shkaktuara nga shirat

RAHOVEC, 5 KORRIK (ER) - Komisionet e formuara me vendim të kryetarit të Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, kanë përgatitur raportet mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga shirat e rrëmbyeshëm dhe breshëri në infrastrukturë publike, shkolla, fusha sportive, në bujqësi, dëmet e shkaktuara në amvisëri dhe në ekonomi familjare. "Anëtarët e këtyre komisioneve pas vizitave të

bëra në terren kanë përgatitur raporte dhe, bazuar në këto raporte, vlera e përgjithshme e dëmeve të shkaktuara nga shirat e rrëmbyeshëm dhe breshëri është 5 milionë e 252 mijë e 984.15 euro. Raportet e vlerësimit të dëmeve i janë dorëzuar kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinajt, në vizitën e tij të bërë në Komunën e Rahovecit", është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Rahovecit.



PROBLEME THEMELORE TË PUNIMEVE STUDIMORE (2)



Hajdin ABAZI

3. Sfida e parë, titulli i temës

Problemi i aspektit teorik të problemit studimor rrallë ndodhë të jetë formal apo i strukturës, në këtë aspekt, duket zakonisht mjaft mirë i parashtruar; ndonëse ka vend edhe këtu për të dëshiruar më tepër, nuk e konsideroj si problem themelor, ndaj nuk do të merrem më tepër me të.

Problemi që kam shquar dhe që më shqetëson ka të bëjë me aspektin përmbajtësor. Në kuptimin që shpesh nuk ka një rrjedhë logjike, ka s'përputhje, dhe shpërqendrim në kahet që supozohet t'i ketë punimi studimor. Këtu do të jem konkret.

Sfida e parë që një autor ballafaqohet e që duhet t'i japë zgjidhje është ajo e përcaktimit të titullit të studimit. Prirja është për tituj të përgjithshëm, sepse më lehtë mund të futet gjithçka brenda atij titulli dhe faqet të plotësohen pa ndonjë vështirësi. Gjithsesi, kjo mund të jetë edhe pasojë e mos përvijës (ndonëse këtu duhet të japë kontributin e vet mentori si udhëheqës shkencor). Titujt me tema të përgjithshme duhet të shmangen. Sido që të jetë, nëse zgjidhet një titull i përgjithshëm, do të ishte e preferueshme që përmes një nëntitulli të lokalizohet ose konkretizohet fokusi i temës së përgjithshme. Kjo e ngushton fushën e studimit dhe mundëson një studim të thelluar.

Atraktiviteti i titullit të përgjithshëm qëndronte ajo se besohet se fare lehtë mund t'i përshtatet thuaja çdo formulim i qëllimit studimor. Por kur do të vijë puna të realizimi i studimit atëherë do të shfaqeshin vështirësi të shumta, pikërisht si pasojë e temës së përgjithshme (si, p. sh., çka të përfshihet e çka të lihet jashtë etj.). Vështirësia e këtyre, sikurse u tha, mund të shmanget përmes nëntitullit, që e përcakton fokusin e studimit. Kjo është një zgjidhje. Më e mira do të ishte, një titull teme të jetë konkret, nga se mundëson një studim të mirëfilltë e shumë të fokusuar.

4. Rëndësia e përcaktimit të qëllimit të studimit

Pasi të jetë gjetur një titull për temën, pason hapi tjetër - përcaktimi i qëllimit të studimit.

Ndonëse duket më i lehtë përcaktimi i një qëllimi për një titull të përgjithshëm teme, sugjeroj si më sipër të shmanget titulli i përgjithshëm, pasi që është një lehtësi mashtruese sepse do të shfaqë shumë vështirësi gjatë realizimit të studimit.

Në anën tjetër, një temë konkrete, në shikim të parë, duket se e ka më të vështirë përcaktimin e një qëllimi të studimit. Kjo sepse kërkohet një thellësi, depërtim deri në themel të temës dhe shtrirje të perimetrit që do të përfshijë thuaja tërësisht atë që shtrihet në rrezen e temës konkrete.

Formulimi i qëllimit kërkon shumë mendim, shoshitje e prova. Kur të bëhet, nuk duhet kënaqur. Për të shkruar një qëllim sa më të përshtatshëm me temën, kërkohet shqyrtim nga autori: a është i përcaktuar qartë qëllimi, a është në harmoni me temën, a e mbulon tërë temën, nëse realizohet qëllimi a do të mund të arrihet ndonjë njohje për temën, dhe a do të përfshihet e tëra apo do të mbetet diçka jashtë?

Këto dhe pyetje të ngjashme ndihmojnë për të kuptuar nëse formulimi i qëllimit të studimit është i tillë që do ta bënte studimin të plotë dhe të mirëfilltë.

5. Vështirësia më e madhe, përcaktimi i objektivave studimore

Titulli i temës dhe qëllimi zakonisht janë sfidat më të lehta për një punim studimor, sepse zgjidhja dhe harmonizimi i tyre është më i arritshëm. Këtë e tregon edhe fakti se në të shumtën e herave titulli i temës dhe qëllimi i një punimi studimor përcaktohen pak a shumë në mënyrë korresponduese.

Se përse duhet t'i kushtohet vëmendje përpilimit të qëllimit të studimit ka një arsye të fortë - ai duhet të jetë gjeneruesi i pjesëve të tjera të studimit. Një formulim i qartë, i plotë dhe shprehës i qëllimit që i korrespondon mirë temës, është parakusht që strukturat e tjera të hyrjes të formulohen me qartësi dhe harmoni të duhur.

Kështu, pas qëllimit, zakonisht vjen parashtrimi i objektivave të studimit. Objektivat e studimit, për të qenë në funksion dhe për të ndihmuar studimin, duhet të jenë një operacionalizimi i qëllimit, respektivisht një përimtim, fragmentarizim, pjesëzim i qëllimit. Objektivat e këtyre e bëjnë më të dukshme dhe më të qartë se sido të mund të arrihej qëllimi i studimit.

Sigurisht nuk është gjithnjë e vetëkuptueshme se cilat objektiva mund të nxirren nga qëllimi i studimit. Por ka një mundësi për të kontrolluar nëse objektivat

janë në funksion të arritjes së qëllimit. Për ta bërë më praktike, le të supozohet se janë nxjerrë pesë objektiva nga një qëllim i studimit. Atëherë, për secilin objektiv veç e veç duhet pyetur - çka konkretisht objektivi (1, 2, 3, 4 dhe 5) do të ndihmonte në arritjen e qëllimit? Kjo do të mund të ndriçonte faktin se a është apo jo dhe në ç'masë secili objektiv (1, 2, 3, 4 dhe 5) studimor njëmend në funksion të arritjes së qëllimit të studimit apo jo. Po ashtu, edhe se a e mbulojnë ato në tërësi qëllimin e studimit.

Po qe se hetohet ndonjë s'përputhje, ndonjë formulim i panevojshëm, jashtë rrezes qëllimit apo ndonjë mangësi etj., atëherë secila duhet korrigjuar dhe rishkruar.

Duhet mbajtur parasysh se secili studim ka rrezik që të lajthitet nga objektivat. Kam parë jo rrallë objektiva të shtruar që dalin jashtë rrezes së temës, ose që nuk janë thuaja aspak në funksion të temës, apo që e zgjerojnë panevojshëm temën duke e rritur gamën e studimit që nuk rrjedhë nga qëllimi. Kjo mund të jetë pasojë e papërvijës, ose shkak i punës nën stres (gjithsesi edhe i kujdesit të munguar të mentorit si udhëheqës shkencor). Sido që të jetë, kjo e dëmton karakterin studimor dhe duhet t'i kushtohet vëmendje, që objektivat as të mos jenë të shumta sa t'u humb kuptimi, as të mos jenë të mangëta sa të mos çojnë në realizimin e qëllimit.

Që të mos ndodhë kjo, ose të pakësohet mundësia e lajthitjes, do të mund të veprohej në mënyra të ndryshme. Për shembull, të lexohet secili objektiv nga perspektiva e tjetrit, ose sikur të ishin shkruar ato nga ndonjë studiues tjetër dhe detyra është të ekzaminohet përputhja e secilit objektiv me qëllimin e studimit. Ose, ndoshta edhe më mirë, t'i jepet për lexim ndonjë kolegu, që ta ekzaminojë raportin e secilit objektiv me qëllimin.

Po e ilustrujmë këtë figurativisht. Le të mendohet qëllimi si një mozaik. Ky mozaik përbëhet nga pesë pjesëza. Secila pjesëz është një segment, që paraqet diçka të mozaikut. Vetëm kur të vihen të gjitha pjesëzat së bashku dhe në rendin e vendin e duhur atëherë dhe vetëm atëherë zbulohet pamja e plotë dhe e qartë e mozaikut, domethënë arrihet qëllimi. Këtë funksion duhet ta kenë objektivat studimore në raport me qëllimin.

Kalibrimi i objektivave me qëllimin e studimit, sa më mirë që të bëhet dhe me synim që të arrihet një operacionalizim i duhur, është njëra prej strukturave të hyrjes që duhet t'i kushtohet vëmendja e madhe, sepse ka rëndësi vendimtare për koherencën e pjesës tjetër të studimit.

6. Pyetjet studimore, një orientim se si mund të bëhen ato

Dy pjesët tjera të strukturës së hyrjes që pasojnë pas objektivave zakonisht janë pyetjet studimore dhe hipotezat.

Çka janë pyetjet studimore në një punim studimor?

Përgjigja me karakter praktik do të ishte se ato janë pyetje të shtruar të cilave duhet dhënë përgjigje. I tërë studimi, duhet të jetë i tillë, që, në fund, të çojë në përgjigje për secilën pyetje të shtruar.

Me fjalë të tjera, ato janë si busulla orientimi, se cilat duhet të jenë kahet ku duhet të fokusohet studimi, për të arritur, si rezultat i gjetjeve të studimit, në përgjigjet ashtu sikurse ato do të jenë.

Për dallim nga tema dhe qëllimi, si dhe objektivat e studimit, pyetjet studimore në praktikën e deritashme janë problematike, në shkrimin e të cilave janë shpërfaqur dy mungesa të mëdha:

e para mungesë është, se zakonisht pyetjet studimore nuk janë të përputhshme me objektivat e shtruar të studimit; dhe e dyta, që buron nga e para, përgjigjet e arritura në fund të studimit nga gjetjet, zakonisht nuk sugjerojnë ndonjë gjë me vlerë për ndonjërin objektiv. Këto të dyja kanë mundësi të kapërcehen dhe të gjejnë zgjidhje. Ajo që do të propozoj në vazhdim ka të bëjë me aspektin logjik, dhe që është praktike dhe orientuese.

Mënyra më e natyrshme do të ishte që pyetjet studimore të formulohen duke ndjekur secilin objektiv veç e veç të studimit. Kjo është shumë e thjeshtë. Le të kujtojmë se më sipër u tha që hipotetishtë janë përcaktuar

pesë objektiva studimore. Atëherë, edhe pyetjet studimore do të duhej të ishin po pesë. Secili objektiv, veç e veç, do të duhej të kthehej në pyetje kërkimore. Domethënë, pesë objektiva japin pesë pyetje studimore, secila pyetje studimore i korrespondon saktësisht secilit objektiv përkatës të studimit. Konkretisht: objektivi i të parë i korrespondon pyetja e parë studimore, objektivi të dytë pyetja e dytë e kështu me radhë.

Duhet mbajtur parasysh se mund të ketë raste kur një pyetje studimore mund të mos mbulojë tërë rrezen e objektivit dhe ka nevojë të ketë edhe nënpyetje studimore. Përveç se është më i lehtë dhe afërmendsh formulimi sipas kësaj logjike i pyetjeve studimore, ajo ka edhe rrjedhoja konkrete për vetë studimin. Fjala vjen, gjetjet e studimit që do të çonin në përgjigjen e parë do të ishin tregues i qartë, por edhe argument, që do të tregonte përmbushjen e objektivit të parë. Ose e kundërta, po qe se përgjigja në pyetjen e parë studimore do të ishte negative, ose jo e kënaqshme, atëherë edhe objektivi përkatës do të kishte të njëjtin fat, apo do t'i pësonte të njëjtat konsekuenca. Është normale që përgjigja pozitive të çonte në përmbushjen e objektivit prej të cilit është deduktuar, si dhe përgjigja negative ose jo e kënaqshme të kishte të njëjtat pasojë për objektivin, të ishte i papërmbushur ose i përmbushur në mënyrë jo të kënaqshme.

(Vijon)

(Autori është prof. ass. dr. dhe ka ligjëruar për shumë vite lëndët Shkrimi akademik dhe Metodologjia e hulumtimit shkencor)



Punëtorët e Postës sot në grevë

Prishtinë, 5 korrik (ER) - Punëtorët e Postës sot (e premte) do të mbajnë grevë njëorëshe. Sipas një njoftimi për medie të Sindikatës së këtyre punëtorëve, gjatë kësaj kohe do të mbyllen të gjitha zyrat postare në Kosovë. Greva do të mbahet prej orës 13:00 deri në orën 14:00. "Kjo grevë njëorëshe është vetëm hapi ynë i parë sindikal që do të pasohet edhe me veprime të tjera sindikale deri në realizimin e plotë të kërkesave të punëtorëve të PK Sh. A.", thuhet në njoftimin e Sindikatës.

BE-ja ndryshon rregullat e lëvizjes në Shengen

BRUKSEL, 5 KORRIK - Një plan i ri është miratuar të enjten në Parlamentin Evropian për t'i verifikuar udhëtarët, të cilëve nuk u duhet viza për të hyrë në zonën Shengen. Ky plan, sipas Unionit, është i ngjashëm me Sistemin Elektronik të Shteteve të Bashkuara për Autorizim të Udhëtimit dhe synon të "identifikohen kriminelët, terroristët dhe kushdo që përbën rrezik para se të

arrijë në BE", thuhet në deklaratë. Sipas planit të miratuar nga ligjvënësit evropianë më 5 korrik, udhëtarët nga 60 vende që nuk janë pjesë e Bashkimit Evropian, duke përfshirë Gjeorgjinë, Moldavinë, Ukrainën dhe shumicën e shteteve të Ballkanit Perëndimor, do të jenë pjesë e një procesi verifikues para se të arrijnë në kufirin e Shengenit, duke përdorur Sistemin informativ dhe

Autorizues të Udhëtimit në Evropë.

Propozimi duhet të miratohet edhe zyrtarisht nga shtetet anëtare të BE-së, në mënyrë që ky sistem të zbatohet nga viti 2021, ka njoftuar BE-ja.

Plotësimi i një aplikacioni pritet të zgjasë afër 20 minuta dhe do të kushtojë 7 euro, ndërsa i njëjti do të jetë falas për fëmijët nën moshën 18-vjeçare.



Britania përgatitet për vizitën e presidentit Trump

Presidenti i ShBA-së, Donald Trumpi, pritet që më 12 korrik ta realizojë udhëtimin e parë si president në këtë vend që është një prej aleatëve më të vjetër të Amerikës. Megjithatë, pritet që protesta masive ta shoqërojë vizitën e udhëheqësit amerikan në Britani



LONDËR, 5 KORRIK - Presidenti Trump pritet të shkojë në Britani më 12 korrik për udhëtimin e parë si president në këtë vend që është një prej aleatëve më të vjetër të Amerikës, megjithëse kjo nuk do të jetë një vizitë shtetërore. Forca e kësaj aleance speciale është vënë në provë kohët e fundit dhe pritet që protesta masive ta shoqërojë vizitën e udhëheqësit amerikan në Britani.

Britania është goditur nga një valë të nxehti, si nga klima atmosferike, po ashtu edhe ajo politike. Vizita e pritshme e presidentit Trump ka mobilizuar ata që kundërshtojnë politikën e udhëheqësit amerikan për tema si imigracioni apo ndryshimet klimatike. "Do të dal të protestoj. Nuk jam nga ata që shkojnë në demonstrata, por këtë radhë besoj me forcë se ai nuk është i mirëpritur", thotë një banore. "Nuk jam krejt dakord me shumë gjëra që ai ka bërë por, gjithashtu, mendoj se ka bërë plot gjëra të mira për Amerikën. Prandaj e mbështes vizitën. Ai është aleati ynë",

thotë një banor.

Në Londër janë planifikuar protesta, por ato do të jenë larg pikave ku do të ndodhet presidenti. "Nuk duam një grup të vogël, por shumë të zhurmshëm dhe agresiv të portretizohet si popullata e gjerë britanike", thotë David Sergeant i Institutit për Politika Konservatore.

Presidenti Trump dhe kryeministrja Theresa May patën një fillim të mirë me takimin në Shtëpinë e Bardhë në 2017, por tani marrëdhënia mes tyre është vënë në provë. "Ripostimi i videos së ekstremit të djathtë nga presidenti Trump shkaktoi një stuhitë debatesh në parlament si dhe protesta në rrugë. Tani ai po vjen këtu ndërkohë që po vendos tarifa kundër Evropës, kur po tërhiqet nga marrëveshja me Iranin dhe ndërkohë që ka pasur një stuhitë negative mediatike për politikën e tij për t'i ndarë fëmijët nga prindërit", thotë Leslie Vinjamuri e Grupit të Politikave "Chatham House".

Vizita e Trumpit ndodh në një periudhë kritike për Britaninë,

ndërsa finalizon largimin nga BE-ja. Qeveria britanike beson se një marrëdhënie e fortë ekonomike dhe sigurie me Shtetet e Bashkuara është jetike për një të ardhme të suksesshme jashtë Bashkimit. "Në epokën e Brexitit duhet të ndërtojmë aleanca në të gjithë globin. Nuk ka aleancë më të fortë sesa ajo që kemi me Shtetet e Bashkuara", thotë analisti Sergeant. Tani ngrihet pyetja nëse edhe presidenti Trump e konsideron

po aq të rëndësishme marrëdhënien me Britaninë. "Besoj se do të riafirmohet marrëdhënia e Amerikës me Britaninë, si dhe mund të ketë një formë angazhimi për një marrëveshje tregtare, por nuk pres të shohim shumë rezultate konkrete pasi Trumpi të largohet. Vëmendja do të rikthehet te tema si bashkëpunimi në sferën e sigurisë dhe NATO-ja", thotë analistja Vinjamuri. Presidenti Trump do të shkojë

në Londër pas takimit të NATO-s në Bruksel. Pas Londrës ai shkon në Helsinki për takim me presidentin Putin. "Këto janë takime shumë më të rëndësishme për presidentin amerikan sesa vizita në Londër", thotë analistja Vinjamuri. Ndërkohë që mijëra veta përgatiten për protesta masive, perceptimi që do të krijojë vizita në të dyja anët e Atlantikut do të ketë rëndësi të konsiderueshme për matjen e suksesit.

BE-ja vazhdon sanksionet kundër Rusisë

BRUKSEL, 5 KORRIK - Bashkimi Evropian ka vazhduar edhe zyrtarisht sanksionet ekonomike kundër Rusisë deri më 31 janar të 2019-s.

Sanksionet e vëna fillimisht më 2014 janë masë ndëshkuese për Rusinë, pas vendimit të kësaj të fundit për ta aneksuar Krimenë si dhe për mbështetjen e separatistëve rusë në konfliktin në lindje të Ukrainës.

Sanksionet janë miratuar më 5 korrik dhe vijnë pas debatit të liderëve të Bashkimit Evropian

për këtë çështje në samitin që është mbajtur në Bruksel më 29 qershor.

Sanksionet godasin sistemin bankar dhe atë të energjisë në Rusi.

Në samitin e BE-së, kancelarja gjermane Angela Merkel dhe presidenti francez Emmanuel Macron kanë informuar homologët e tyre evropianë për nivelin e zbatimit të marrëveshjeve të Minskut, të cilat janë të lidhura me sanksione. Marrëveshjet e Minskut janë

arritur më 2014 dhe 2015 në kryeqytetin bjellorus, me qëllim të zgjidhjes së konfliktit dhe kanë bërë thirrje për një varg marrëveshjesh për armëpushim në lindje të Ukrainës, mirëpo asnjëra prej tyre nuk ka qenë e suksesshme.

Nga prilli i vitit 2014 më shumë se 10 000 persona kanë vdekur në luftimet në mes të forcave të Kievit dhe separatistëve, që kontrollojnë disa zona në rajonet Donetsk dhe Luhansk në lindje të Ukrainës. Të dyja



palët akuzojnë njëra-tjetër për shkelje të vazhdueshme të marrëveshjeve. Liderët e BE-së do ta shqyrtojnë mundësinë e

vazhdimin të sanksioneve pas muajit janar, në takimin e tyre të planifikuar për muajin dhjetor.

Malsorja, një ambasadore e Kosovës në Uganda të Afrikës

"Duhet përmendur se këtu në Uganda gjendet edhe një lagje që ka emrin Kosova. Isha kureshtarë të di si ka ardhur ky emër në Afrikë. Gjatë një vizite në kryeqytetin e Ugandës, Kampala në Kishën Protestante në lagjen 'Kosova', u takova me priftin e kishës dhe aty e kuptova të vërtetën rreth emrit", ka thënë Malsore Llapashtica, e cila ka arritur të shkojë në Afrikë për t'i shkolluar fëmijët jetim në organizatën "Uganda Volunteer Foundation"

PRISHTINË, 5 KORRIK - Malsorja është një ndër femrat e cila me bamirësinë e saj ka arritur të shkojë në Afrikë për t'i shkolluar fëmijët jetimë në organizatën "Uganda Volunteer Foundation". Ajo që e ka inspiruar autoren është vuajtja e fëmijëve shqiptarë nga lufta e Kosovës. Ishte ëndrra e

ur, Zoti është i vetëm që i mban të ngopur dhe plot energji", ka thënë Malsorja, e cila ka treguar një histori që askush nuk e di në Kosovë. "Duhet përmendur se këtu në Uganda gjendet edhe një lagje që ka emrin Kosova. Isha kureshtarë të di si ka ardhur ky emër në Afrikë. Gjatë një vizite në



saj që t'u ndihmojë fëmijëve jetimë në Afrikë. "Kam nderim të jem në mesin e këtyre fëmijëve që të inspiroj dhe mësoj për jetën, dashurinë dhe besimin. Këtu gjen fëmijë që nuk kanë ngrënë bukë me javë, por atë që kam gjetur këtu është buzëqeshja e tyre. E them të drejtën këtu në këtë vend jeton Zoti, sepse edhe pse të urit-

kryeqytetin e Ugandës, Kampala në Kishën Protestante në lagjen 'Kosova', u takova me priftin e kishës dhe aty e kuptova të vërtetën rreth emrit. Ai më tha se kemi dëgjuar në atë kohë për luftën e ish-Jugosllavisë, për luftën në Kosovë, gjenocidin e bërë gjatë asaj kohe dhe me keqardhje për të gjithë kosovarët

e prekur nga lufta. Dhe çdo ditë ishim ne që jemi lutur në Zot që t'i ndihmojë popullit kosovar. Andaj sot për kujtimin e luftës e thërrasim lagjja 'Kosova' në Kampala të Ugandës. Ai, po ashtu, tha se është hera e parë që na viziton dhe na ndihmon një njeri nga ish-Jugosllavia, sidomos nga Kosova dhe ishte shumë i lumtur dhe mirënjohës", ka thënë ajo.

Malsorja pas luftës ishte ferma e parë si anëtare e Karvanit si shkrimtare e Kosovës, që në atë kohë karvani vizitonte fëmijët jetimë në mbarë Kosovën me trauma të luftës me rast të qëllimit të vizitës ishte që përpos vizitave edhe t'u recitonin poezi dhe t'u ofronin pozitivitet të jetës. Malsorja ishte edhe në Indi dhe në vende të tjera të botës. Ajo

është një ndër autorët kosovare e cila ka marrë pjesë në shumë antologji botore. Në muajin prill ishte e ftuar në Singapor si moderator për hapjen e festivalit botëror me poezi, por nuk ia doli për shkak të udhëtimit në Kanada. "Isha e gatshme të udhëtoj në Singapor ku, përpos prezantimit të Kosovës me poezi të mia, kryetari i kësaj shoqate më zgjodhi për hapjen solemne dhe moderatore e festivalit.

Mirëpo të njëjtën kohë shtëpia botuese në Montreal më ka ftuar të jam e pranishme gjatë seleksionimit të librit për botim", ka treguar Malsorja. Llapashtica ka botuar libra në gjuhën italiane dhe se me të njëjtin libër ka prezantuar Kosovën në mesin autorëve italianë në Lecce të Italisë. Ajo deri më tani ka botuar tri libra, kurse dy libra të tjerë janë në botim në gjuhën angleze dhe italiane.



E rrallë

Rruga shkrihet si "akullore", tërbohen shoferët

Bitumi që ka shkrire nga nxehtësia i ka detyruar shoferët në Australi t'i braktisin automjetet e tyre pasi gomat u veshën me katran. Deri në 50 shoferë mund ta kenë të drejtën e kompensimit për incidentin në Queensland të martën. Incidenti thuhet se ndodhi prej një ndryshimi të motit.



BARSOLETA E DITËS



Pyet shoku shokun?
 - A e njeh atë njeri?
 - Po, ai së shpejti martohet dhe do të bëhet milioner.
 - Pse çka po fiton me martesë?
 - Një milion probleme.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjate vikendit në ora 16:00

"INCREDIBLES 2" 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

Rolet: Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

Regjia: Brad Bird



FOTO E DITES



Flamujt e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) me rastin e 242-vjetorit të pavarësisë. /AP/


Në ora 18:20

"FUTURE WORLD"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

Regjia: James Franco



Në ora 20:00

"ANT-MAN AND THE WASP" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

Rolet: Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

Regjia: Peyton Reed



Në ora 22:00

"LOVING PABLO" (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

Rolet: Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

Regjia: Fernando León de Aranoa



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).

E rrallë

Arrestohet 'Sulltani i monedhave'

Policia iraniane ka arrestuar një burrë, për të cilin thonë se kanë grumbulluar dy ton monedha ari për ta manipuluar tregun lokal. Shefi i policisë së Teheranit, gjeneral Hossein Rahimi, ka thënë se 58-vjeçari i pidentifikuar kishte përdorur bashkëpunëtorët për të mbledhur rreth 250 000 monedha gjatë 10 muajve të fundit. Ai e quajti atë "Sulltan i monedhave".



DASHI
Do të keni disa shqetësime në ambientin e punës. Megjithëse jeni shumë të përkushtuar, përsëri do të keni përplasje me kolegët.



DEMI
Dita kalon e qetë në shoqëri të njerëzve që ju pëlqen të rrini. Momente të këndshme dhe argëtuese do të jenë bashkudhëtarët tuaj sot.



BINJAKËT
Jeni zgjuar me humor të keq sot dhe personat që do të përballen me ju duhet të kenë shumë kujdes. Do të keni një debat të ndezur me një koleg në punë.



GAFORRJA
Sot do të kuptoni se një person të cilin e konsideroni mik ndjen shumë më tepër për ju. Ose do t'i mirëprisni ndjenjat e tij ose do të tërhiqeni pa arsye.



LUANI
Po reflektoni lidhur me një vendim të marrë kohë më parë. Mbase po të ktheheshit pas në kohë do të kishit ndryshuar diçka.



VI RGJËR ESHA
Sot jeni të lumtur me dashurinë dhe do të keni edhe argëtim me fëmijët, por ka një element që gjatë pasdites do t'ua prish disi harmoninë e përgjithshme.



PESHORJA
Detyrat që ka secili prej jush në familje nuk do të respektohen nga të gjithë. Kjo do të sjellë debate dhe probleme ditën e sotme.



AKREPI
Megjithëse në raportin në çift ka keqkuptime, sot do të uleni për t'i zgjidhur. Dialogu dhe komunikimi është gjëja më e mirë që mund të bëni.



SHIGJETARI
Fokusi juaj sot do të jetë ana financiare. Keni shpenzime të papritura që nuk do të mund t'i përballoni dot.



BRICJAPI
Kreativiteti dhe sensi praktik do të jenë një kombinim i këndshëm sot dhe do të japë frytet e veta në një fushë të caktuar.



UJORI
Sot do të jeni më pak sensibel se zakonisht dhe do të keqkuptoni disa sjellje të personave që ju qëndrojnë pranë.



PESHQIT
Ndjenjat tuaja po shkojnë drejt personit të gabuar. Nuk do të arrini ta vëreni këtë gjë që në fillim, por do të lëndoheni kur ta kuptoni.

EURO GLASS
SAINT-GERMAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

URUGUAY - FRANCE

GG

BRAZIL - BELGIUM

GG

BATE BORISOV - TORPEDO

1

Ndeshje të zjarra në çerekfinalen e Botërorit

Dy ndeshje të zjarra do të zhvillohen sot (e premte) në kuadër të çerekfinalës së Kupës së Botës. Fillimisht nga ora 16:00 do të përballen Uruguai dhe Franca, kurse në mbrëmje nga ora 20:00 zhvillohet përballja tjetër në mes të Brazilit dhe Belgjikës

"Epoka e re"

MOSKË, 5 KORRIK - Kupa e Botës, pas një pushimi prej dy ditësh, rikthehet me dy ndeshje tejet të forta. Uruguai dhe Franca përballen sot (e premte) në kuadër të çerekfinalës së Kupës së Botës "Rusi 2018". Në stadiumin "Nizhny Novgorod" përballen Franca dhe Uruguai. Këto kombëtare ende nuk kanë pësuar asnjë humbje dhe synimet i kanë të vazhdojnë me këtë ritëm, ani pse njëra duhet të eliminohet nga ky kompeticion. Në 1/8 e finales, Franca arriti me një paraqitje të mirë ta eliminojë Argentinën e Lionel Messit, kurse në anën tjetër Uruguai e eliminoi Portugalinë e Cristiano Ronaldos. Kjo ndeshje është speciale edhe për Antoine Griezmann dhe Lucas Hernandez, pasi përballen me shokët e skuadrës së Atletico Madridit, Diego Godin dhe Jose Gimenez, ndërsa përballë do të jenë edhe sulmuesit e Paris Saint-Germain: Edinson Cavani dhe Kylian Mbappe, sikurse dyshja e Juventusit, Rodrigo Bentancur dhe Blaise Matuidi. Përballje edhe më interesante pritet të jetë dyshja e Barcelonës, Luiz Suarez ndaj Samuel Umtitit. Ndeshja e dytë çerekfinale zhvillohet nga ora 20:00 në "Kazan Arena" në mes të Brazilit dhe Belgjikës. Këto dy kombëtare llogariten edhe si kryesoret për të triumfuar në këtë Botëror. Brazili, pas barazimit në ndeshjen e parë ndaj Zvicrës, është paraqitur mirë në ndeshjet e tjera dhe në këtë përballje hynë si



favorit ndaj Belgjikës që ka një formë të mirë, por ndeshja e fundit në 1/8 e finales ndaj Japonisë ka lënë vend për dyshime se Belgjika mund ta rrëmbejë trofeun, ani pse arriti ta përmbysë epërsinë prej dy golave të japonezëve. Ndërsa brazilianët u kualifikuan në çerekfinale pasi fitores 2-0 ndaj Meksikës. Siç dihet, Brazili ka një ekip të fuqishëm të udhëhequr nga Neymari dhe Coutinho, por edhe belgët kanë një skuadër mjaft të mirë me yjet që luajnë në Premier Ligë si Lukaku, De Bruyne dhe Hazard.

FORMACIONET E MUNDSHME

Uruguai: Muslera; Caceres, Godin, Gimenez, Laxalt; Nandez, Torreira, Vecino; Bentancur; Suarez, Stuani.
Franca: Lloris; Pavard, Varane, Umtiti, Hernandez; Kante, Pogba; Mbappe, Griezmann, Lemar; Giroud.
Brazili: Alisson, Fagner, Silva, Miranda, Luis, Paulinho, Fernandinho, Coutinho, William, Firmino, Neymar.
Belgjika: Courtois, Alderweireld, Kompany, Vertonghen, Meunier, De Bruyne, Witsel, Chadli, Hazard, Mertens, Lukaku.

SHKURT

Sot zgjidhet kryetari i FFK-së

Kuvendi i Jashtëzakonshëm i Federatës së Futbollit të Kosovës për zgjedhjen e presidentit të FFK-së do të mbahet sot (e premte) nga ora 17:00. Ky kuvend do të mbahet në Hotel "Emerald" dhe do të zgjidhet pasuesi i Fadil Vokrrit, i cili javë më parë papritmas ndërroi jetë si pasojë e një sulmi në zëmër. Fadil Vokri ishte mjaft i suksesshëm si kryetar i FFK-së, pasi arriti t'i thyejë barrierat ndërkom-bëtare për pranimin e futbollit të Kosovës në UEFA dhe FIFA.

Shaqirin, pas Liverpoolit, e kërkon edhe Unitedi

Xherdan Shaqiri sezonin e ri futbollistik mund të presë në një skuadër të madhe në Premier Ligë. Fillimisht interesim për lojtarin nga Zhegra e Gjilanit kishte shfaqur Liverpooli kurse tash, sipas "The Sun", Shaqirin e dëshiron edhe Manchester Unitedi. Edicionin e fundit shqiptari ishte pjesë e skuadrës së Stoke Cityt, por pas rënies së saj nga elita edhe Shaqiri do të largohet.

Caktohen gjyqtarët e çerekfinaleve të Botërorit

FIFA ka përzgjedhur gjyqtarët e katër ndeshjeve që do të zhvillohen të premten dhe të shtunën. Kampionati Botëror ka hyrë në fazën më interesante, ku kanë mbetur edhe tetë kombëtare në rrugëtimin drejt finaleve të madhe. Ndeshjen e parë në mes të Uruguait dhe Francës do ta gjykojë gjyqtari nga Argjentina, Nestor Pitana. Takimi tjetër i së premtes në mes të Belgjikës dhe Brazilit i është besuar serbit Milorad Maziq. Bjorn Kuipers i Holandës do të jetë gjyqtari kryesor i sfidës së mes të Suedisë dhe Anglisë, kurse takimin e fundit të çerekfinaleve ku përballen Kroacia dhe Nikoqirja, Rusia, do ta drejtojë braziliani Sandro Ricci.

Prishtina arrin sukses historik në Evropë

"Epoka e re"

PRISHTINË, 5 KORRIK - Skuadra fituese e Kupës së Kosovës në futboll, Prishtina ka arritur sukses historik në garat ndërkom-bëtare, pasi e siguruar kualifikimin në fazën e parë kualifikues në Evropa Ligë. Deri të ky sukses, Prishtina erdhi pas fitores bindëse në ndeshjen e dytë ndaj Europa FC (5-0), kurse ndeshja e parë kishte përfunduar 1-1. Prishtina e nisi mirë lojën duke rrezikuar pas gjashtë minutave lojë, por Khalid dështoi të shënoi në një rast të mirë shënimi. Tre minuta me vonë Abdul Basit Khalid nxori një penallti të cilën në gol e konvertoi Armend Dallku, për rezultatin 1-0. Në minutën e 13-të, Gauthier Mankenda realizoi një gol të bukur për rezultatin 2-0. Dominimi i Prishtinës vazhdoi edhe në minutat në vazhdim, kurse Khalid (35) u pengua për herë të dytë në zonën e rreptësisë, derisa Dallku sërish i pagabueshëm ishte nga



penalltia për rezultatin 3-0. Në fund të pjesës së parë, Meriton Korenica e lëshoi një rast të mirë për të shënuar golin e katërt, kurse në pjesën e dytë Prishtina shënoi edhe dy gola të tjerë. Në minutën e 59-të, Ahmed Januzi pas një kundërsulmi e

mposhti pa problem portierin Javi Munoz, derisa katër minuta para fundit Mërgim Pefqeli e vulosi rezultatin final 5-0. Ky është sukses historik për futbollin e Kosovës, kurse Prishtina përfiton 240 mijë euro.

Lorenzo: Nuk mund të fitoj në çdo garë

MADRID, 5 KORRIK - Fitoi dy gara radhazi, hyri në garë për titullin kampion në Moto GP, por në pistën e Assen zhgënjeu, duke u renditur i shtati, edhe pse në pjesën e parë të garës ishte mes më të mirëve. Spanjoli Jorge Lorenzo nuk arriti të triumfojë edhe në Holandë, duke humbur sërish terren ndaj kreut. Piloti i Ducatit e ka marrë me filozofi këtë rezul-

tat. "Starti i garës ishte i mirë për mua, të gjithë frenuan nga pjesa e brendshme e pistës, ndërsa unë në atë të jashtme, pasi para hapësira dhe fitova 2-3 pozicione. Pjesa e parë e garës ishte e mirë, por më pas gjërat ndryshuan", ka deklaruar Lorenzo. "E kryesova garën për shumë xhiro, por më pas nuk kisha më ritmin e duhur dhe kur ndryshonte drejtimi kisha

probleme e vështirësi, duke humbur terren. Përpiqesha të fitoja terren në pjesët e drejta, por pa sukses. Gjithsesi, jam i kënaqur, pasi ky ishte maksimumi dhe e di që unë e Ducati dhamë më të mirën në pistë. Në fund të fundit, nuk mund të fitosh në çdo garë, ndaj duhet të punojmë për t'u rikthyer te fitorja në garën e ardhshme, në Gjermani".



UEFA zyrtarizon ndryshimin historik për sezonin e ardhshëm

NYON, 5 KORRIK - Prova "paqeje" në mes të UEFA-s dhe FIFA-s. Pasi organizmi më i madh i futbollit evropian dhe atij botëror kanë ndërmarrë rrugë të ndryshme mbi VAR-in, i përdorur në Kupën e Botës, në Nyon kanë vendosur ta përdorin zëvendësimin e katërt gjatë kohës shtesë të ndeshjeve me eliminim direkt, duke filluar që nga sezoni i ardhshëm i Ligës së Kampionëve, Ligës së Evropës dhe Superkupën e Evropës. Ky rregull vlen edhe për Ligën e Kampionëve për femra, Evropianin 2021 të fermave dhe Euro 2020 të meshkujve. Kështu, pranohet vija e punës e presidentit Infantino, e adoptuar menjëherë nga trajnerët e skuadrave që luajnë në Botëror, që kanë përfituar nga një rregull që jep mundësinë e përdorimit të forcave të freskëta në 30 minutat e shtesës para ekzekutimit të mundshëm të penalltive. Kështu, UEFA ka mirëpritur ndryshimin e vendosur nga International Board marsin e



kaluar: Aleksandr Erokhin ka qenë zëvendësuesi i parë i katërt në historinë e Botërorit, i aktivizuar në vend të Dzyuba gjatë ndeshjes Rusi - Spanjë të Kupës së Botës, por eksperimenti është bërë më parë në

Botërorin për Klube të 2016-s, kur Alvaro Morata ka marrë vendin e Cristiano Ronaldo në finalen e luajtur kundër Kashima Alters.

Abidali poston foton me kushëririn që i dhuroi mëlçinë

BARCELONË, 5 KORRIK - Erik Abidal ka postuar një foto me kushëririn në spital, në një tentativë të re për t'i përgënjeshtuar pretendimet se ish-presidenti i Barcelonës, Sandro Rosell, e ka blerë në mënyrë të paligjshme mëlçinë për të.

Ish-mbrojtësi i Francës u operua me urgjencë në vitin 2011, pasi iu zbulua një tumor në mëlçi, ndërsa kushëririn i tij Zherard dhuroi mëlçinë. Megjithatë, shtypi spanjoll këtë javë raportoi se Rosell, i arrestuar në vitin 2017 për pjesëmarrje në pastrim parash, e kishte blerë veshkën. Barcelona ka mohuar çdo akuzë, ndërsa Abidal dhe Hospital Clinic në Barcelonë, ku ai u operua, gjithashtu kanë mohuar çdo aludim.

Abidal, tashmë sekretar teknik te Barça, ka postuar një foto në "Twitter", ku shkruan: "Me publikimin e këtij imazhi dua të kërkoj respekt për kushëririn tim Zherard, për ta mbrojtur nderin e tij. Denoncoj publikisht sjelljen e



disa medieve që vazhdojnë të ngrenë pikëpyetje rreth ligjshmërisë së një ndërhyrjeje që më shpëtoi jetën! Mjaft më!"

SHKURT

Ronaldon orët e ndajnë nga transferimi në Juventus

Ylli i Portugalisë, Cristiano Ronaldo, është i vendosur për një aventurë të re. Largimi i tij nga skuadra e Real Madridit bëhet i sigurt nga mediet italiane, të cilat raportojnë se portugezi ka marrëveshje me Juventusin, por mbetet të arrihet vetëm marrëveshja ndërmjet klubeve. "Zonja e Vjetër" ka ofruar 100 milionë euro Realin për Ronaldon, kurse ky i fundit do të përfitojë 30 milionë euro në sezon. Në anën tjetër, Reali pritet të sjellë si zëvendësim për Ronaldon, Neymarin që është pjesë e PSG-së.

Dy skuadra turke e kërkojnë Ajetin

Mbrojtësi i Kombëtares së Shqipërisë, Arlind Ajeti, karrierën mund ta vazhdojë në futbollin turk. Mediet shqiptare kanë raportuar sot se Ajetin e dëshirojnë Beshiktashi dhe Kasimpasa. Kartonin e Ajetit e ka skuadra e Torinos, por mbrojtësi nuk bën pjesë në planet e kësaj skuadre dhe e ardhmja me gjasë do të jetë larg Serisë A.

Joshua mbron titujt në shtator dhe prill

Dy duelet e ardhshme të Anthony Joshuas do të zhvillohen në stadiumin e Wembleyt. Kampioni i peshave të rënda do të kthehet në stadiumin legjendar më 22 shtator të këtij viti, ndërsa shatë muaj më vonë, më 3 prill të vitit 2019, do të ketë edhe duelin e dytë. Joshua dhe promotori i tij, Eddie Hearn, ende nuk kanë konfirmuar kundërshtarët e 28-vjeçarit, por pritet të jenë Deontay Wilder ose Alexander Povetkin. "Do të rikthehem në Wembley pas dy dueleve të zhvilluara në Cardiff. Dua t'i falënderoj përkrahësit nga Uellsit dhe Britania e Madhe dhe njerëzit në Londër që po presin kthimin tim", ka thënë Joshua.

Williami nuk flet për transferimin në Barcelonë

Ylli i Chelseat, William nuk ka dashur të flasë për mundësinë e transferimit gjatë këtij afati kalimtar te Barcelona. "Kam parë disa spekulime rreth Barcelonës, por kjo nuk është koha për të folur për këtë. Jam i përqendruar në Kupën e Botës dhe kjo është e gjitha për të cilën kujdesemi tani për tani", ka thënë William.

Messi e dëshiron Pogban te Barça

Lionel Messi dëshiron që Barcelona të nënshkruajë me mesfushorin e Manchester Unitedin, Paul Pogba. Sipas "calciomercato", pasi nuk arritën ta marrin Antoine Griezman këtë verë nga Atletico Madridi, Barça ka kthyer vëmendjen te francezi, me Pogban që shihet si një përmirësim i mesfushës bashkë me Paulinhon. Arritja e Pogbas në "Camp Nou" do t'i jepte hapësirë Philippe Coutinho për të lëvizur në krah, duke mbështetur më shumë Messin në sulm.

Karius mbetet portieri i parë i Liverpoolit

Portieri gjerman Loris Karius pritet të jetë portieri i parë i Liverpoolit edhe në edicionin e ri futbollistik. "Reds" kërkuar transferimin e portierit të Romës, Alisson Beckerin dhe atë të Atletico Madridit, Jan Oblakin, por marrëveshjet dështuan dhe gjermani edhe përkundër dy gabimeve në finale ndaj Realit do të jetë numri një në portën e Liverpoolit.



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren University "Ukshin Hoti" Prizren

Pranuar me dt. 05.07.2018
Zyra e pranimit Nr. i protokolit
308 01-122/A

